

REPublika e Kosovës-REPublika KOSOVO
KOMUNA E SHTIMËS/OPŠTINA ŠTIMLJE

Nr i Pro/Br Prot 02/133

Nr i Faqeve/Br.strana _____

Data/Dana/ 23.02.2024

SHTIME/ŠTIMLJE



23/02/2024
02/104

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Komuna e Shtimës
Republika e Kosovës
Përfaqësuar nga/
Qemajl Aliu, Kryetar

dhe

OPEA Bardha
Organizata per Promovim Barazi dhe Avokim
Rr. "Shaip Spahiu" nr. 42, Lagjja e Muhagjerve 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Përfaqësuar nga/
Bardha Sadrija, Drejtoreshë Ekzekutive

në kuadër të projektit
"Fuqizimi i Grave Të Burgosura përmes Artit dhe Ndërgjegjësimit"

Neni 1. **Subjekti i kësaj Marrëveshjeje**

Subjekt i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit (me tej: MB) është bashkëpunimi në mes të Komunës së Shtimës dhe OPEA Bardha në kuadër të projektit "Fuqizimi i Grave Të Burgosura përmes Artit dhe Ndërgjegjësimit", të financuar nga Organizata "HELP", ndërsa zbatohet nga OPEA Bardha.

Projekti do të realizohet në periudhën kohore duke filluar nga muaji Janar 2024 deri në Mars 2024.

Neni 2.

Shpjegim i shkurtër i projektit

Ky projekt është e përshtatur për gratë dhe vajzat nga mosha 18 deri në 60 vjeç, aktualisht në shërbimin korrektues të Kosovës. Objektivi ynë është të rrisim ndërgjegjësimin e këtyre grave për statusin e tyre socio-ekonomik. Duke promovuar në mënyrë aktive angazhimin e të burgosurave në ekonominë formale, ne synojmë të zvogëlojmë prevalencën e ekonomisë joformale. Për më tepër, përpjekjet tona janë të dedikuara për të inkurajuar të burgosurat për të marrë pjesë në tregun e punës, duke nxitur mundësitë për riintegrimin e tyre në shoqëri dhe duke kontribuar në mirëqenien e tyre të përgjithshme. Ky projekt përputhet me objektivat kryesore për të kontribuar në reduktimin e përjashtimit social dhe ekonomik të grupeve vulnerabël në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në përputhje me qëllimet e programit, projekti adreson në mënyrë specifike disa objektiva kyçe.

Përshkrimi i Aktiviteteve

Aktiviteti 1: Hyrje në Linjën e Përpunimit dhe Bazat e Tekstilit

Aktiviteti 2: Trajnim me makinë qepëse dhe praktikë me gjilpërë

Aktiviteti 3: Menaxhimi i kohës dhe strategjitë efikase të qepjes

Aktiviteti 4: Pasqyrë e procesit të prerjes së materialit

Aktiviteti 5: Praktikë në makinat e vogla prerëse

Aktiviteti 6: Përgatitja e modelit të materialit të avancuar të makinës

Aktiviteti 7: Metodatat e qepjes dhe matja e kohës

Aktiviteti 8: Riperseritje e të gjithave funksioneve të makinave.

Mbështetja do të përfshijë:

Zbatimi i aktiviteteve të përmendura do të financohet në shumën totale të donatorit të kostos direkte **4,000.00EUR**, ndërsa Komuna e Shtimës do të kontribuojë financiarisht 85.7% të shumës totale të investimit që është **3,500.00Euro** në drejtim të realizimit të projektit në kuadër të Komunës së Shtimës.

Neni 3.

Komuna e Shtimës do të transferojë në llogarinë e OPEA Bardha kontributin në shumën prej **3,500.00 EURO** si pjesëmarrje në drejtim të zbatimit të projektit në kuadër të Komunës së Shtimës (tutje "Kontribut"). Kontributi i Komunës së Shtimës do të transferohet në llogarinë e OPEA Bardha (19710027190331253) në BKT siç përcaktohet në paragrafin e parë të këtij neni, në një këst jo më vonë se 29.02.2024.

OPEA Bardha merr përsipër të përdorë kontributin vetëm për objektivat e projektit. OPEA Bardha është përgjegjës për zbatimin e projektit dhe Kontributin e dhënë ta përdor në mënyrë të duhur. Kontributet nga të gjithë donatorët do të transferohen në llogari të OPEA Bardha për tu përdorur ekskluzivisht për zbatimin e projektit.

OPEA Bardha do të marrë përgjegjësinë për menaxhimin e përgjithshëm të Projektit dhe do të jetë përgjegjës për zbatimin e përmendur. OPEA Bardha do të ofrojë projektin në përputhje me rezultatet dhe rezultatet aktuale

Neni 4.
Monitorimi dhe Raportimi

Secila pale do te emëroj stafin e saj për monitorimin e këtij projekti. Ne lidhje me aktivitetet ne kuadër te Komunës se Shtimës, OPEA Bardha do te paraqes raporte narrative mbi ecurinë e zbatimit te projektit ne baze te rregulloreve te Donatoreve dhe një raport përfundimtar, brenda tre muajve nga data e përfundimit te Projektit. Te dyja palët bien dakord për shkëmbimin e informacionit ne kuadrin e Projektit gjate gjithë kohës gjate zbatimit te tij.

Neni 5.
Klauzole konfidencialiteti

Te dyja palët bien dakord për konfidencialitetin e te gjitha te dhënave te përdorura brenda kuadrit te bashkëpunimit. Te gjitha dokumentet dhe informatat do te mbeten vetëm për përdorim te brendshëm dhe nuk mund te përdoret për qëllime tjera, pa miratim me shkrim nga OPEA Bardha dhe Komuna e Shtimës.

Neni 6.
Kohëzgjatja, ndryshimet e MB

Marrëveshja do te hyje ne fuqi ditën e nënshkrimit te saj dhe do te përfundojë ne 31.01.2025 me mundësi te ndryshohet me anekset e shkruara siç është propozuar nga nënshkruesit.

Neni 7.
Mosmarrëveshjet

Çdo marrëveshje ndërmjet nënshkruesve te kësaj marrëveshje te zgjidhen ne mënyre miqësore me marrëveshje të përbashkët dhe ne vullnet të mirë. Nëse një zgjidhje miqësore nuk mund të arrihet, te gjitha mosmarrëveshjet do të zgjidhen përfundimisht para gjykatës kompetente ne Prishtinë.

Neni 8.
Gjuha

Kjo marrëveshje është përgatitur ne një gjuhe (shqip) dhe e nënshkruar ne dy kopje identike, te cilat secili nënshkrues mban një kopje.

Data: 23.2.2024
Në Shtime
Për Komunën e Shtimës
Qemajl Aliu
Kryetar i komunës



Për OPEA Bardha
Bardha Sadrija
Drejtoreshë Ekzekutive

